



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:126142

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05510231

CP.nr.1108/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, përmes gjyqtarit individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në lëndën përbarimore të kreditorit T.P nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.Berat Peci, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës, jashtë seancës gjyqësore me datë 27.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e kreditorit T.P nga Mitrovica, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës.

Arsyetim

Me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.1108/2022 e datës 12.10.2022 është caktuar përbarimi sipas propozimit të kreditorit T.P nga Mitrovica, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës.

Me parashtrësën e datës 21.03.2024, kreditori e ka njoftuar gjykatën se borxhi në këtë çështje është ekzekutuar dhe kërkojnë që procedura të perfundoj.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 i LPP-së, i cili flet për përfundimin e procedurë përbarimore ma saktësisht par. 4 i po të njëjtit nen thotë citoi “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përbarimore”, e nga të lartëcekurat pasiqë borxhi është paguar në tërësi e **PËRFUNDOJ** procedurën përbarimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, e konform nenit 66 paragrafi 4 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përbarimore) është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
CP.nr.1108/2022, datë 27.03.2024

GJYQTARI
Fuad Haliti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditore nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.